



REPUBLIKA E SHQIPËRISË

ENTI RREGULLATOR I ENERGJISË  
SEKRETARIA

Nr. \_\_\_\_ Prot.

Tiranë, më \_\_\_\_ .03.2021

**MBLEDHJA Nr. 13,**  
**datë 04.03.2021, ora 15:00**  
**e Bordit të ERE-s**

Në zbatim të (i) nenit 13 të Ligjit Nr. 43/2015, “Për Sektorin e Energjisë Elektrike”; të ndryshuar, (ii) Rregullores bazë së Organizimit dhe Funksionimit të Entit Rregullator të Energjisë të miratuar me Vendimin e ERE-s Nr. 144/2019 dhe (iii) nenit 11 të “Rregullores për Organizimin, Funksionimin dhe Procedurat e ERE-s” miratuar me Vendimin e Bordit të ERE-s Nr.96, datë 16.07.2016, (iv) Aktit Normativ të Këshillit të Ministrave Nr. 8, datë 24.03.2020 “Për disa shtesa dhe ndryshime në aktin normativ nr. 3, datë 15.03.2020, të Këshillit të Ministrave, “Për marrjen e masave të vecanta administrative gjatë kohëzgjatjes së periudhës së infeksionit të shkaktuar nga COVID – 19”, të ndryshuar, njoftojmë se **ditën e Enjte, datë 04.03.2021, ora 15:00**, do të zhvillohet mbledhja nr. 13 e Bordit të ERE-s, sipas këtij rendi dite:

1. Mbi shqyrtimin e kërkesës së shoqërisë “Seman Sunpower” sh.p.k., për transferim të aseteve (vendosje hipoteke) në favor të “Intesa Sanpaolo Bank” sh.a.
2. Mbi përfundimin e procedurave për heqjen e licencave të shoqërisë “Sang 1” sh.p.k., për veprimtarinë e prodhimit të energjisë elektrike dhe për veprimtarinë e tregtimit të energjisë elektrike, si dhe mbi dhënien e autorizimit nga ana e ERE-s për shitjen e 79 % të kuotave të shoqërisë “Sang 1” sh.p.k.
3. Çështje të tjera

Në zbatim të: (i) pikës 1 të Urdhërit të kryetarit të ERE-s nr. 53, datë 11.03.2020, “Për ushtrimin e veprimtarisë së Entit Rregullator të Energjisë dhe zhvillimin e mbledhjeve apo seancave dëgjimore me qëllim mbrojtjen e shëndetit të popullatës nga infeksioni i shkaktuar nga COVID-19”; (ii) Urdhërit nr. 53/1, datë 24.03.2020 “Për një ndryshim në urdhërin nr. 53, datë 11.03.2020”, “Për ushtrimin e veprimtarisë së Entit Rregullator të Energjisë dhe zhvillimin e mbledhjeve apo seancave dëgjimore”; (iii) Urdhërit nr. 53/2 datë 01.06.2020, “Për ushtrimin e veprimtarisë së Entit Rregullator të Energjisë dhe zhvillimin e mbledhjeve apo seancave dëgjimore gjatë gjendjes së epidemisë së shkaktuar nga Covid-19”; dhe (iv) Urdhërit nr. 19, datë 19.02.2021, “Për ndryshimin e pikës 1, të Urdhërit nr. 53, datë 11.03.2020, “Për ushtrimin e veprimtarisë së Entit Rregullator të Energjisë dhe zhvillimin e mbledhjeve apo seancave dëgjimore”, për lejimin e pjesëmarrjes së palëve të treta, nëpërmjet platformave të teknologjisë së komunikimit elektronik, për sa i përket zhvillimit të mbledhjeve të hapura të Bordit, si dhe zhvillimin e seancave dëgjimore teknike apo publike.

Palët e interesit për pjesëmarrje në mbledhjen e bordit të ERE-s, duhet të dërgojnë me shkrim kërkesën për pjesëmarrje, në postën elektronike, në adresën [erealb@ere.gov.al](mailto:erealb@ere.gov.al), jo më vonë se 24 orë para datës së njoftuar të mbledhjes, si dhe çështjen të cilën janë të interesuar të ndjekin.

**KRYETARI I ERE**  
**Petrit AHMETI**